



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 18.10.2019

VENDIM

Nr. 59, datë 18. 10. 2019

PËR

**"MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019"**

Mbështetur në nenin 32, shkronjën g të pikës 1 të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 5, datë 19. 02. 2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatet për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e përbashkët me Bordin e Administrimit, të datës 18. 10. 2019,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin vjetor të veprimtarisë së UV për vitin akademik 2018-2019, hartuar nga Rektorati, konform të dhënave, informacioneve dhe vlerësimeve të përgatitura nga SA dhe BA dhe sugjerimeve të bëra përgjatë kësaj mbledhjeje, të cilat reflektohen në procesverbalin e saj.
2. "Raporti Vjetor i veprimtarisë së UV për vitin akademik 2018-2019", t'i nënshtrohet në vijim korrektimit elektronik dhe gjuhësor.
3. "Raporti Vjetor i veprimtarisë së UV për vitin akademik 2018-2019" i korrektuar, t'i përcillet SA dhe BA, të cilët në një seancë tjetër, vijim i kësaj mbledhjeje, miratojnë Raportin e korrektuar.
4. Ngarkohen Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, (grupi mësimor i gjuhësisë), për korrektimin gjuhësor dhe Sektori i IT-së për formatimin dhe unifikimin elektronik të këtij Raporti.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi arkivohet dhe sëbashku me Raportin Vjetor të veprimtarisë së UV për vitin akademik 2018-2019, (të korrektuar) i dërgohet MASR dhe gjithë autoriteteve dhe organeve drejtuese kolegjiale, personelit akademik dhe strukturave ndihmësakademike e administrative të UV-së.
7. "Raporti Vjetor i veprimtarisë së UV-së për vitin akademik 2018-2019" shpallet në WEB-in e UV-së.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

